



MUNDËSI PËR PJESËMARRJE NË KURSIN E TRAJNIMIT PËR GJUHËN ARABE NË EGJIPT (15 MARS-16 PRILL 2020)

“Agjencia Egjiptiane e Partneritetit për Zhvillimin” në bashkëpunim me Institutin e Studimeve Arsimore dhe Kërkimeve të Universitetit të Kajros, do të organizojë një kurs trajnimi për studentët e huaj universitarë për mësimin e gjuhës arabe në Kajro të Egjiptit gjatë periudhës 15 Mars 2020-16 Prill 2020.

Për kursin e mësipërm të trajnimit, pala egjiptiane fton edhe kandidatë nga Shqipëria. Kandidatët duhet të jenë në vazhdim të studimeve universitare dhe të ketë njohje të nivelit mesatar të gjuhës arabe. Pjesëmarrja në këtë kurs synon:

- Arritjen e aftësive funksionale të gjuhës arabe në aspektet: dëgjim, të folurit, lexim dhe shkrim;
- Zhvillimin e aftësive për përdorimin gramatikor të gjuhës arabe;
- Njohjen me kulturën arabe egjiptiane të lidhura me perspektivat dhe vlerat specifike në etikën gjuhësore.
- Zhvillimin e aftësive komunikuese në gjuhën arabe;
- Zhvillimin e aftësive për bashkëpunimin kulturor në gjuhën arabe përmes analizave dhe interpretimit të teksteve autentike të zhanreve të ndryshme.

“Agjencia Egjiptiane e Partneritetit për Zhvillimin” do të përballojë të gjitha shpenzimet e pjesëmarrjes në kursin e trajnimit që përfshijnë: tarifat e kursit, transportin ndërkombëtar, akomodimin në hotel, transportin e brendshëm.

Kandidatët e interesuar për pjesëmarrje në këtë kurs duhet të dorëzojnë brenda datës 27.02.2020 në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë:

1. Formularin e aplikimit të plotësuar që gjendet bashkëlidhur këtij njoftimi,
2. Një kopje të CV në gjuhën angleze;
3. Letër mbështetëse nga Universiteti përkatës;
4. Certifikatën e njohjes së gjuhës arabe (nëse ka);
5. Fotokopjen e faqes së pasaportës me të dhënat e identitetit.

Nënvizojmë se përzgjedhja e kandidatëve për pjesëmarrje në këtë kurs do të bëhet mbi bazën e dokumenteve të mësipërme. Gjatë këtij procesi do të mbahet në konsideratë kriteret e vendosura nga pala egjiptiane.

DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS